

VENDIM
Nr. 46, datë 13.6.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 15, DATË 28.4.2017, “PËR LICENCIMIN E
SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME TEPELENË”**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe Rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë sh.a., për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 15, datë 28.4.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë”;
- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë ka aplikuar me anë të shkresës nr. 624 prot., datë 4.5.2018, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor;
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë sh.a., plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në Rregulloren e licencimit mbi ndryshimin e drejtuesit ligjor, konkretisht:
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Drejtuesi ligjor plotëson kriteret e parashikuara në Rregulloren e licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 15, datë 28.4.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor Jetnor Haska”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani